

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2740/Prot.

Durrës më, 21.11.2025

V E N D I M

Nr. 145, datë 21.11.2025

PËR

“MIRATIMIN E RREGULLORES SË QENDRËS SË TRASHËGIMISË
KULTURORE MESJETARE, NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU”
DURRËS”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; të Statutit të UAMD-së; të Rregullores së UAMD-së; referuar shkresës Nr. 2100/2 prot., datë 22.10.2025 të Drejtorit të Qendrës së Trashëgimisë Kulturore Mesjetare, si dhe referuar shkresës Nr. 2100/3 prot., datë 28.10.2025 të Drejtorisë Juridike, në mbledhjen e datës 21.11.2025, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores së Qendrës së Trashëgimisë Kulturore Mesjetare, në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:
 - Zv. Rektorët
 - Drejtori i Qendrës së Trashëgimisë Kulturore Mesjetare
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
QENDRA E TRASHËGIMISË KULTURORE MESJETARE

RREGULLORE

E

**QENDRA E TRASHËGIMISË KULTURORE MESJETARE
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës**

Miratuar me Vendim Nr. Datë 21/11/2025 të Senatit Akademik
145,
të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës

Neni 1

Dispozita të Përgjithshme

Rregullorja synon të përcaktojë normat e përgjithshme që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Trashëgimisë Kulturore Mesjetare, për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së saj në shërbim të universitetit, ndërlidhjes midis fakulteteve të UAMD, promovimit të trashëgimisë kulturore, zhvillimin e aktiviteteve hulumtuese dhe informuese mbi trashëgiminë, artin, historinë, arkeologjinë dhe vlerat kombëtare përmes përfshirjes dhe bashkëpunimit me stafin akademik, studentët, ekspertët vendas e të huaj si edhe me institucione partnere lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Neni 2

Baza Ligjore

Rregullorja e Qendra e Trashëgimisë Kulturore Mesjetare, mbështetet në vendimin nr. 62, date 19.11.2024 i Bordit të Administrimit të UAMD. Kodin e Punës, Kodin e Procedurave Administrative, Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore në zbatim të tij, Statutin (miratuar me urdhër Nr.385, datë 09.07.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë) dhe Rregulloren (miratuar me Vendim nr. 154, datë 26.11.2018 të Senatit Akademik) të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, të cilat janë baza kryesore juridike e kësaj rregulloreje.

Rregullat e përgjithshme mbi funksionimin e Qendra e Studimeve të Trashëgimisë Kulturore, janë për zbatim. Në rast kundërshtie me këtë rregullore, do të zbatohen aktet në bazë të parimit të hierarkisë së normave.

Neni 3

Qëllimi dhe Misioni

1. Qendra e Trashëgimisë Kulturore Mesjetare (në vijim: Qendra) është një njësi kërkimore-shkencore pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, me mision hulumtimin, ruajtjen, dokumentimin, promovimin dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore shqiptare dhe arbëreshe, si dhe forcimin e ndërgjegjësimit për rëndësinë e saj në akademi dhe shoqëri.
2. Qendra ndërvepron përmes disiplinave të ndryshme të arkeologjisë dhe historisë, trashëgimisë materiale dhe shpirtërore, turizmit kulturor dhe historisë së artit, studimeve të kërkimit, organizimit të projekteve, publikimit të rezultateve dhe synon të funksionojë si një hapësirë e hulumtimit, punës dhe shkëmbimit të mendimit ndër fakultetet e UAMD, institucioneve dhe qendrave të fushës në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
3. Qendra synon të ndërveprojë në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar me njësi shtetërore, akademike dhe jo-qeveritare, me qëllim arritjen e bashkëpunimeve në avancimin e studimeve të vlerësimeve dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.
4. Qendra funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, aktet normative të MAS dhe rregulloren e brendshme të Universitetit.

Neni 4

Objektivat Kryesore

1. Të zhvillojë hulumtime, studime shkencore dhe projekte kërkimore në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale.
2. Të dokumentojë dhe arkivojë të dhëna mbi trashëgiminë kulturore shqiptare dhe atë të komuniteteve arbëreshe në Itali, vende të tjera me komunitete arbëreshe, me institucionet publike e jopublike me fokus arbëreshët që operojnë në Shqipëri dhe jashtë vendit.
3. Të hulumtojë dhe promovojë historinë, vlerat, vokacionin dhe përkatësinë evropiane të Shqipërisë.
4. Të punojë për promovimin e Aleksandër Moisiut, figurës së shquar, emrin e së cilit mban institucioni.
5. Të organizojë konferenca, simpoziume, trajnime, work-shop-e dhe aktivitete publike që promovojnë trashëgiminë kulturore.
6. Të publikojë artikuj shkencorë, revista dhe botime të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore.
7. Të inkurajojë përfshirjen e studentëve dhe stafit akademik në projekte kërkimore dhe aktivitete hulumtuese, edukative mbi trashëgiminë kulturore.
8. Të aplikojë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare dhe hartojë projekte në bashkëpunim me institucione dhe aktorë publik e jopublik në shërbim të misionit dhe objektivave të Qendrës dhe në dobi të UAMD.
9. Të punojë për botimin e katalogëve periodik mbi trashëgiminë kulturore materiale dhe shpirtërore.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
QENDRA E TRASHËGIMISË KULTURORE MESJETARE

10. Të ofrojë kushte dhe mundësi për praktika studendore për studentët.
11. Të punojë për krijimin e një muzeu historik, arkeologjik dhe kulturor përmes mjeteve materiale dhe digjitale në ambientet e UAMD.
12. Të organizojë ekspedita me studentë dhe staf akademik në site të trashëgimisë kulturore.
13. Të shërbejë si një urë lidhëse midis UAMD dhe institucioneve të kulturës dhe trashëgimisë në qeverisjen vendore, qendrore dhe ato jashtë vendit.
14. Të krijojë e mundësojë bashkëpunim me qendra dhe institucione të kulturës dhe trashëgimisë në qeverisjen vendore, qendrore dhe ato jashtë vendit.
15. Të organizojë shkolla verore/dimërore në shërbim të promovimit të trashëgimisë kombëtare dhe lidhjes ndërkulturore me vende e kultura të tjera.

Neni 5

Struktura Organizative

1. Qendra e Trashëgimisë Kulturore Mesjetare është strukturë në fuqi e miratuar sipas vendimit nr. 62, date 19.11.2024 i Bordit të Administrimit të UAMD.
2. Qendra drejtohet nga një Drejtor, i cili emërohet nga Rektori i Universitetit në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e UAMD.
3. Qendra mund të ketë një bord koordinues, të përbërë nga një përfaqësues nga stafi akademik për çdo fakultet të UAMD, një përfaqësues nga institucionet publike e jo publike strategjike për objektivat, aktivitetet dhe hulumtimet e Qendrës, si edhe një përfaqësues nga Këshilli Studentor, duke mbuluar fusha të veçantë si:
 - o Fusha e Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe Jomateriale
 - o Fusha e Projekteve dhe Start-upeve kulturore
 - o Fusha e Studimeve Arbëreshe
 - o Fusha e Marrëdhënieve me Institucionet dhe Grupet e Interesit
 - o Fusha e promovimit dhe hulumtimit përmes digjitalizimit
 - o Fusha e botimeve
 - o Fusha e turizmit arkeologjik dhe kulturor
 - o Fusha e promovimit përmes nismave dhe projekteve studentore.
4. Roli i bordit koordinues është të përbëhet nga individë që ndërlidhin Qendrën dhe aktivitetet e Qendrës me fakultetet e UAMD, institucionet jashtë UAMD, studentët, dhe fushat e lartpërmendura. Ky bord krijohet përmes konsultimit të Drejtorit të Qendrës me Rektorin, ka rol honorifik e mbledhet me kërkesën e Drejtorit të Qendrës sipas nevojave që ka Qendra.
5. Qendra mund të ketë bashkëpunëtorë të brendshëm dhe të jashtëm, si akademikë, studiues, ekspertë dhe institucione partnere.
6. Qendra, në përputhje me ritmin dhe masën e aktiviteteve të saj, mund të synojë shtimin e strukturës me personel administrativ dhe akademik me kohë të plotë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren dhe procedurat e UAMD.

Neni 6

Detyrat e Drejtorit

Detyrat e Drejtorit të Qendrës janë që në konsultim të vazhdueshëm me Rektorin e Universitetit të ndjekë e verë në zbatim objektivat kryesore të saj të përcaktuara në këtë rregullore:

1. Drejtori punon që Qendra të zhvillojë hulumtime, studime shkencore dhe projekte kërkimore në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale.
2. Të krijojë lidhje e të ndërmarrë nisma për dokumentimin dhe arkivimin e të dhënave mbi trashëgiminë kulturore shqiptare dhe atë të komuniteteve arbëreshe në Itali, vende të tjera me komunitete arbëreshe, me institucionet publike e jopublike me fokus arbëreshët që operojnë në Shqipëri dhe jashtë vendit.
3. Të hulumtojë dhe promovojë historinë, vlerat, vokacionin dhe përkatësinë evropiane të Shqipërisë e t'i vendosë këto hulumtime e promovime në shërbim të Universitetit.
4. Të punojë për ideimin e mjeteve dhe sigurimin e materialeve promovuese për figurën e Aleksandër Moisiut, emrin e së cilit mban UAMD.
5. Të jetë nismëtar i organizimit të konferencave, simpoziumeve, trajnimeve, work-shop-ve dhe aktiviteteve publike që promovojnë trashëgiminë kulturore.
6. Të shërbejë në krijimin e mjeteve akademike e mundësive për publikimin e artikujve shkencorë, në revista dhe botime të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore.
7. Të gjenerojë hapësira për inkurajimin e përfshirjes së studentëve dhe stafit akademik në projekte kërkimore dhe aktivitete hulumtuese, edukative mbi trashëgiminë kulturore.
8. Të ndjekë e iniciojë aplikime në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të punojë për hartimin e projekteve në bashkëpunim me institucione dhe aktorë publik e jopublik në shërbim të misionit dhe objektivave të Qendrës dhe në dobi të UAMD.
9. Të synojë e punojë për botimin e katalogëve periodik mbi trashëgiminë kulturore materiale dhe shpirtërore.
10. Të ideojë mundësi që ofrojë kushte dhe mundësi për praktika studendore për studentët.
11. Të ideojë plane e të shërbejë si ndërlidhës me studiues, individë, filantropë e institucione, për krijimin e një muzeu historik, arkeologjik dhe kulturor përmes mjeteve materiale dhe digjitale në ambientet e UAMD.
12. Të ideojë e realizojë organizimin e ekspeditave me studentë dhe staf akademik në site të trashëgimisë kulturore.
13. Të shërbejë si një urë lidhëse midis UAMD dhe institucioneve të kulturës dhe trashëgimisë në qeverisjen vendore, qendrore dhe ato jashtë vendit.
14. Të krijojë e mundësojë bashkëpunime të reja me qendra dhe institucione të kulturës dhe trashëgimisë në qeverisjen vendore, qendrore dhe ato jashtë vendit.
15. Të ideojë e organizojë shkolla verore/dimërore në shërbim të promovimit të trashëgimisë kombëtare dhe lidhjes ndërkulturore me vende e kultura të tjera.

Neni 7

Bashkëpunimi Institucional

1. Qendra bashkëpunon ngushtë me:
 - o Bashkinë e Durrësit, në funksion të zhvillimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore të qytetit dhe zonave përreth.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
QENDRA E TRASHËGIMISË KULTURORE MESJETARE

- Qendrat dhe Institucionet e Trashëgimisë Kulturore, si Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Muzeu Arkeologjik i Durrësit, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Arkeologjisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, etj.
 - Qendrat Studimore dhe Kulturore Arbëreshe brenda dhe jashtë Shqipërisë.
 - Shkolla, qendra, institute, universitete dhe organizata kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare që trajtojnë tema të trashëgimisë kulturore dhe identitetit kombëtar.
2. Qendra mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucione, organizara dhe subjekte të ndryshme për realizimin e projekteve të përbashkëta, shkëmbimin e informacionit, organizimin e aktiviteteve dhe publikimeve të përbashkëta.

Neni 8

Aktivitetet dhe Projektet

1. Qendra harton dhe zbaton projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e:
 - Dokumentimit dhe digjitalizimit të trashëgimisë kulturore.
 - Edukimit kulturor, historisë, artit dhe ndërgjegjësimit qytetar.
 - Promovimit të turizmit kulturor të qëndrueshëm.
 - Hapjen e ekspozitave përmes zhanerave të ndryshme.
 - Forcimit të urave kulturore me vende të tjera, diasporën dhe komunitetet arbëreshe.
2. Qendra mund të aplikojë për fonde publike dhe private, si brenda Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj, për të mbështetur veprimtarinë kërkimore dhe zhvillimore.

Neni 9

Burimet Financiare

1. Burimet financiare të Qendrës përfshijnë:
 - Buxhetin e alokuar nga Universiteti.
 - Të ardhurat nga projektet dhe programet kombëtare/ndërkombëtare.
 - Donacionet dhe sponsorizimet e ligjshme.
 - Të ardhurat nga aktivitetet publike dhe botimet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren e UAMD.

Neni 10

Përdorimi i Fondeve

1. Fondet e Qendrës të alokuara nga Universiteti do të përdoren për sigurimin e mjeteve materiale të nevojshme për ecurinë e punës, mjete fizike të nevojshme për evente ekspozimi, mjete disiminimi, ekspedita studimore, ekspedita në terren me studentë e staf akademik, katalogë, e cdo mjet tjetër specific të nevojshëm për arritjen e objektivave të Qendrës të përcaktuara në rregullore.
2. Fondet nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare do përdoren sipas specifikave fillestare të shpallura në aplikim.
3. Fondet e donacioneve dhe sponsorizimeve të ligjshme do përdoren sipas specifikave të dakordësuar paraprakisht me donatorët dhe sponsorizuesit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Rregulloren e UAMD.

Neni 11


Sanksione

1. Mosrepektimi i rregullores përbën shkak për procedim disiplinor për çdo punonjës që shkel rregulloren, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi (kur nuk përbën vepër penale). Në sa më sipër, shkelja e rregullores, do të sjellë vendosjen e sanksioneve administrative në bazë të "Kodit të Punës" si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Mosnjohja e rregullores, nuk e justifikon punonjësën nga përgjegjësia dhe sanksionet e lartpërmendura.

Neni 12

Dispozita të Fundit

1. Çdo ndryshim në këtë rregullore bëhet me propozim të Drejtorit të Qendrës dhe miratohet nga Senati Akademik i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
QENDRA E TRASHËGIMISË KULTURORE MESJETARE

Nr. 210 prot.

Durrës, më 17/09/2025

RREGULLORJA E QENDRËS SË TRASHËGIMISË KULTURORE MESJETARE

Drejtuar
Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi
REKTOR

I nderuar z. Rektor

Ju lutem gjeni bashkëngjitur Rregulloren e Qendrës së Trashëgimisë Kulturore Mesjetare e cila përmban misionin, objektivat dhe elementët kryesorë të aktivitetit të Qendrës në shërbim të Universitetit, ndërlidhjes me institucione publike e jo-publike si edhe në dobi të akreditimit institucional.

Duke ju falënderuar,

Dr. Bledar Kurti
Drejtuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
QENDRA E TRASHËGIMISË KULTURORE MESJETARE

Nr. ___ prot.

Durrës, më ___/___/2025



RREGULLORE

E

**QENDRA E TRASHËGIMISË KULTURORE MESJETARE
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës**

Miraturar me Vendim Nr. Datë ___/___/2025 të Senatit Akademik

të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës

Neni 1

Dispozita të Përgjithshme

Rregullorja synon të përcaktojë normat e përgjithshme që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Trashëgimisë Kulturore Mesjetare, për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së saj në shërbim të universitetit, ndërlidhjes midis fakulteteve të UAM, promovimit të trashëgimisë kulturore, zhvillimin e aktiviteteve hulumtuese dhe informuese mbi trashëgiminë, artin, historinë, arkeologjinë dhe vlerat kombëtare përmes përfshirjes dhe bashkëpunimit me stafin akademik, studentët, ekspertët vendas e të huaj si edhe me institucione partnere lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Neni 2

Baza Ligjore

Rregullorja e Qendra e Trashëgimisë Kulturore Mesjetare, mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Punës, Kodin e Procedurave Administrative, Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore në zbatim të tij, Statutin (miraturar me urdhër Nr.385, datë 09.07.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë) dhe Rregulloren (miraturar me Vendim nr. 154, datë 26.11.2018 të Senatit Akademik) të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, të cilat janë baza kryesore juridike e kësaj rregulloreje.

Rregullat e përgjithshme mbi funksionimin e Qendra e Studimeve të Trashëgimisë Kulturore, zbatohen për aq sa është e mundur. Në rast kundërshtie me këtë rregullore, do të zbatohen aktet në bazë të parimit të hierarkisë së normave.

Neni 3

Qëllimi dhe Statusi

1. Qendra e Trashëgimisë Kulturore Mesjetare (në vijim: Qendra) është një njësi kërkimore-shkencore pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, me mision hulumtimin, ruajtjen, dokumentimin, promovimin dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore shqiptare dhe arbëreshe, si dhe forcimin e ndërgjegjësimit për rëndësinë e saj në akademi dhe shoqëri.
2. Qendra ndërvepron përmes disiplinave të ndryshme të arkeologjisë dhe historisë, trashëgimisë materiale dhe shpirtërore, turizmit kulturor dhe historisë së artit, studimeve të kërkimit, organizimit të projekteve, publikimit të rezultateve dhe synon të funksionojë si një hapësirë e hulumtimit, punës dhe shkëmbimit të mendimit ndër fakultetet e UAMD, institucioneve dhe qendrave të fushës në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
3. Qendra synon të ndërveprojë në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar me njësi shtetërore, akademike dhe jo-qeveritare, me qëllim arritjen e bashkëpunimeve në avancimin e studimeve të vlerësimeve dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.
4. Qendra funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, aktet normative të MAS dhe rregulloren e brendshme të Universitetit.

Neni 4

Objektivat Kryesore

1. Të zhvillojë hulumtime, studime shkencore dhe projekte kërkimore në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale.
2. Të dokumentojë dhe arkivojë të dhëna mbi trashëgiminë kulturore shqiptare dhe atë të komuniteteve arbëreshe në Itali, vende të tjera me komunitete arbëreshe, me institucionet publike e jopublike me fokus arbëreshët që operojnë në Shqipëri dhe jashtë vendit.
3. Të hulumtojë dhe promovojë historinë, vlerat, vokacionin dhe përkatësinë evropiane të Shqipërisë.
4. Të organizojë konferenca, simpoziume, trajnime, work-shop-e dhe aktivitete publike që promovojnë trashëgiminë kulturore.
5. Të publikojë artikuj shkencorë, revista dhe botime të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore.
6. Të inkurajojë përfshirjen e studentëve dhe stafit akademik në projekte kërkimore dhe aktivitete hulumtuese, edukative mbi trashëgiminë kulturore.
7. Të aplikojë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare dhe hartojë projekte në bashkëpunim me institucione dhe aktorë publik e jopublik në shërbim të misionit dhe objektivave të Qendrës dhe në dobi të UAMD.
8. Të punojë për botimin e katalogëve periodik mbi trashëgiminë kulturore materiale dhe shpirtërore.
9. Të ofrojë kushte dhe mundësi për praktika studendore për studentët.
10. Të punojë për krijimin e një muzeu historik, arkeologjik dhe kulturor përmes mjeteve materiale dhe digjitale në ambientet e UAMD.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
QENDRA E TRASHËGIMISË KULTURORE MESJETARE

11. Të organizojë ekspedita me studentë dhe staf akademik në site të trashëgimisë kulturore.
12. Të shërbejë si një urë lidhëse midis UAMD dhe institucioneve të kulturës dhe trashëgimisë në qeverisjen vendore, qendrore dhe ato jashtë vendit.
13. Të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me qendra dhe institucione të kulturës dhe trashëgimisë në qeverisjen vendore, qendrore dhe ato jashtë vendit.
14. Të organizojë shkolla verore/dimërore në shërbim të promovimit të trashëgimisë kombëtare dhe lidhjes ndërkulturore me vende e kultura të tjera.

Neni 5

Struktura Organizative

1. Qendra drejtohet nga një Drejtor, i cili emërohet nga Rektori i Universitetit në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e UAMD.
2. Qendra mund të ketë një bord koordinues të përbërë nga një përfaqësues nga stafi akademik për çdo fakultet të UAMD, një përfaqësues nga institucionet publike e jo publike strategjike për objektivat, aktivitetet dhe hulumtimet e Qendrës, si edhe një përfaqësues nga Këshilli Studentor, duke mbuluar sektorë të veçantë si:
 - o Sektori i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe Jomateriale
 - o Sektori i Projekteve dhe Start-upeve kulturore
 - o Sektori i Studimeve Arbëreshe
 - o Sektori i Marrëdhënieve me Institucionet dhe Grupet e Interesit
 - o Sektori i promovimit dhe hulumtimit përmes digjitalizimit
 - o Sektori i botimeve
 - o Sektori i turizmit arkeologjik dhe kulturor
 - o Sektori i promovimit përmes nismave dhe projekteve studentore.
3. Qendra mund të ketë bashkëpunëtorë të brendshëm dhe të jashtëm, si akademikë, studiues, ekspertë dhe institucione partnere.
4. Qendra, në përputhje me ritmin dhe masën e aktiviteteve të saj, mund të synojë shtimin e strukturës me personel administrativ dhe akademik me kohë të plotë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren dhe procedurat e UAMD.

Neni 6

Bashkëpunimi Institucional

1. Qendra bashkëpunon ngushtë me:
 - o Bashkinë e Durrësit, në funksion të zhvillimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore të qytetit dhe zonave përreth.

- Qendrat dhe Institucionet e Trashëgimisë Kulturore, si Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Muzeu Arkeologjik i Durrësit, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Arkeologjisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, etj.
 - Qendrat Studimore dhe Kulturore Arbëreshe brenda dhe jashtë Shqipërisë.
 - Shkolla, qendra, institute, universitete dhe organizata kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare që trajtojnë tema të trashëgimisë kulturore dhe identitetit kombëtar.
2. Qendra mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucione, organizara dhe subjekte të ndryshme për realizimin e projekteve të përbashkëta, shkëmbimin e informacionit, organizimin e aktiviteteve dhe publikimeve të përbashkëta.

Neni 7

Aktivitetet dhe Projektet

1. Qendra harton dhe zbaton projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e:
 - Dokumentimit dhe digjitalizimit të trashëgimisë kulturore.
 - Edukimit kulturor, historisë, artit dhe ndërgjegjësimit qytetar.
 - Promovimit të turizmit kulturor të qëndrueshëm.
 - Hapjen e ekspozitave përmes zhanerave të ndryshme.
 - Forcimiit të urave kulturore me vende të tjera, diasporën dhe komunitetet arbëreshe.
2. Qendra mund të aplikojë për fonde publike dhe private, si brenda Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj, për të mbështetur veprimtarinë kërkimore dhe zhvillimore.

Neni 8

Burimet Financiare

1. Burimet financiare të Qendrës përfshijnë:
 - Buxhetin e alokuar nga Universiteti.
 - Të ardhurat nga projektet dhe programet kombëtare/ndërkombëtare.
 - Donacionet dhe sponsorizimet e ligjshme.
 - Të ardhurat nga aktivitetet publike dhe botimet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren e UAMD.

Neni 9

Dispozita të Fundit

1. Çdo ndryshim në këtë rregullore bëhet me propozim të Drejtorit të Qendrës dhe miratohet nga Senati Akademik i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.